

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Innovex" Shpk**

Sot më datë 01/03/2024 (dymije e njezete e kater), ne palet e meposhtme vendosem:

- Z. Klevens Toka**, i biri i Gjergjit dhe Natashes, i dtl. 01.06.1978, lindur dhe banues ne Tirane, ne Rr. "Duresit", pall. 124, shkalla 1, apart. 6, mbajtes i dokumentit te identifikimit leternjoftim Nr. 033902364 dhe me nr personal H80601183J, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

të nënshkruaj Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate, së cilës i bashkëngjitet (më poshtë "Shtojca 1").

**Neni 1 – Emërtimi
"Innovex" Shpk**

Emërtimi i Shoqërisë është **"Innovex" Shpk.**

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në rr. "Nikolla Tupe", pallati 2, shkalla 4, apartamenti 26, Tiranë, Shqiperi.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

4.1 Shoqëria ka si objekt kryesor veprimtarie:

Konsulence ne fusha te ndyshme, studime, projektme, sipermarrje zbatuese, investimin, sipas rastit; Menaxhimin e pasurive te paluajtshme, ne fushen e ndertimit, qiradhenie, investimin ne pasuri te paluajtshme dhe te luajtshme. Investimin si Investitor ne ndertim dhe Sipermarres per te gjitha llojet e punimeve ndertimore dhe/ose pjese te caktuara ose punime/procese pune ndertimore te caktuara; Import-eksport, perpunim, prodhim dhe tregetim lende te pare leter te thjeshte, celuloze, termike si dhe te gjitha llojet e letrave qe prodhohen dhe tregtohen ne qarkullim; Import-eksport, perpunim, prodhim dhe tregetim lende te pare industriale plastike e artikuj plastik.

Tregetim, Import-Eksport, me shumice e pakice te materialeve te ndertimit, inerte e parafabrikate si dhe prodhimin e perpunimin e tyre. Ne kete kuader, edhe kryerjen e veprimtarise tregtare ne fushen e prodhimit, perpunimit dhe tregetimit te materialeve te ndertimit.

Tregetim, Import-Eksport, me shumice e pakice te artikujve elektrike te te gjitha llojeve, si per sherbim personal, familjar, tregtar, artikuj elektrik qe perdoren nga shoqerite e ndertimit ne ndertimin e banesave, veprave apo objekteve te ndryshme.

Organizim zyre dhe konsulence juridike, konsulence te pergjithshme ne te gjitha fushat, arkitekture, menaxhimi biznesi, ekonomike dhe financiare.

4.2 Per te realizuar objektin e saj, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, financiare dhe kreditimi ashtu si dhe administrimi, si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Më



në përgjithësi, Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 5 – Kapitali themeltar i shoqërisë

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000 (njemije) lekë.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (nje) kuote, kapital i cili paguhet ne para nga Ortaku;

-Z. Klevens Toka, i biri i Gjergjit dhe Natashes, i dtl. 01.06.1978, lindur dhe banues ne Tirane, ne Rr. "Durrësit", pall. 124, shkalla 1, apart. 6, mbajtes i dokumentit te identifikimit leternjoftim Nr. 033902364 dhe me nr personal H80601183J, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, zoterues i 1 (nje) kuote te kapitalit me vlere nominale 1.000 (njemije) leke, qe perfaqeson 100 % (njqind) te kapitalit.

Neni 6 – Ortaket

- 6.1. Ortak i Shoqërisë do te jete:
 1. **Z. Klevens Toka**, i biri i Gjergjit dhe Natashes, i dtl. 01.06.1978, lindur dhe banues ne Tirane, ne Rr. "Durrësit", pall. 124, shkalla 1, apart. 6, mbajtes i dokumentit te identifikimit leternjoftim Nr. 033902364 dhe me nr personal H80601183J, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, zoterues i 1 (nje) kuote te kapitalit me vlere nominale 1.000 (njemije) leke, qe perfaqeson 100 % (njqind) te kapitalit.

Neni 7 – Transferimi i pjesëve të kapitalit

Pjesët e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 – Administratori

- 8.1 Me këtë akt emërohet 1 (nje) Administrator:

Znj. Dorina Mema, e bija e Petritit dhe Razies, e dtl. 18.11.1980, lindur dhe banuese ne Tirane, ne Rr. "Fortuzit", ndertesë 13, hyrja 7, apartamenti 14, mbajtese e dokumentit te identifikimit leternjoftim Nr. 034638945 dhe me nr. Personal I06118044M, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.
- 8.2 Administratori do të ushtroje të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Ligjit 9723 date 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare" te regjistrimit dhe nenit 14 të Statutit.
- 8.3 Administratori i jepen te gjitha fuqite e nevojshme per te kryer te gjitha formalitetet dhe permbushjet e parashikuara per themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit dhe normativave ne fuqi. Per kete qellim, Administratori ka te drejten te ndihohet nga shërbimet e te treteve dhe te konsulentëve te cileve murid t'u delegoje pjeserisht ose teresisht kryerjen e veprimeve te mesiperme.
- 8.4.1 Administratori eshte gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ajo eshte gjithashtu i autorizuar, të firmose të gjitha aktet dhe të marrin përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e veta edhe personave të tjerë me Prokurë te Posaçme.



- 8.4.2 Gjithsesi Administratori nuk mund te nenshkruaje kontrata pengu ose kredie ne emer dhe per llogari te shoqerise, pa vendim te asamblese se ortakeve per kete qellim.
- 8.4.3 Administratori nuk mund te nenshkruaje kontrata per tjetersimin e pasurise se paluajtshme ne emer dhe per logari te shoqerise, pa vendim te asamblese se ortakeve per kete qellim.
- 8.4.4 Administratorit nuk i lejohet te kontraktoje ne cfaredolloj forme qofte, te marrin hua tek shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behen dorezanes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.

Neni 9- Gjuha

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.
- 9.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve dhe dokumentave si më lartë, versioni në shqip do të jetë i vetmi version ligjërishit detyrues.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua lirisht nga ne palët duke shprehur vullnetin e tyre te lire dhe te plote.

ORTAKU I VETEM

Z. Klevens TOKA

KLEVENS TOKA



**STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"Innovex" Shpk**

Sot më datë 01/03/2024 (dymije e njetete e kater), ne palet e meposhtme vendosem:

1. **Z. Klevens Toka**, i biri i Gjergjit dhe Natashes, i dtl. 01.06.1978, lindur dhe banues ne Tirane, ne Rr. "Durrësit", pall. 124, shkalla 1, apart. 6, mbajtes i dokumentit te identifikimit leternjoftim Nr. 033902364 dhe me nr personal H80601183J, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

të nënshkruaj Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

**KAPITULLI I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqëria "Innovex" Shpk (në vijim "Shoqëria") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "Innovex" Shpk.

Neni 3 – Objekti i shoqërisë

- 3.1 Shoqëria ka si objekt kryesor veprimtarie:
Konsulence ne fusha te ndyshme, studime, projektme, sipermarrje zbatuese, investimin, sipas rastit; Menaxhimin e pasurive te paluajtshme, ne fushen e ndertimit, qiradhenie, investimin ne pasuri te paluajtshme dhe te luajtshme. Investimin si Investitor ne ndertim dhe Sipermarres per te gjitha llojet e punimeve ndertimore dhe/ose pjese te caktuara ose punime/procese pune ndertimore te caktuara; Import-eksport, perpunim, prodhim dhe tregetim lende te pare leter te thjeshte, celuloze, termike si dhe te gjitha llojet e letrave qe prodhohen dhe tregtohen ne qarkullim; Import-eksport, perpunim, prodhim dhe tregetim lende te pare industriale plastike e artikuj plastik.
Tregetim, Import-Eksport, me shumice e pakice te materialeve te ndertimit, inerte e parafabrikate si dhe prodhimin e perpunimin e tyre. Ne kete kuader, edhe kryerjen e veprimtarise tregtare ne fushen e prodhimit, perpunimit dhe tregetimit te materialeve te ndertimit.
Tregetim, Import-Eksport, me shumice e pakice te artikujve elektrike te te gjitha llojeve, si per sherbim personal, familjar, tregtar, artikuj elektrik qe perdoren nga shoqerite e ndertimit ne ndertimin e banesave, veprave apo objekteve te ndryshme.
Organizim zyre dhe konsulence juridike, konsulence te pergjithshme ne te gjitha fushat, arkitekture, menaxhimi biznesi, ekonomike dhe financiare.
- 3.2 Per te realizuar objektin e saj, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, financiare dhe kreditimi ashtu si dhe administrimi, si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të



shoqërisë. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 4 – Selia

- 4.1 Selia e Shoqërisë është në rr. "Nikolla Tupe", pallati 2, shkalla 4, apartamenti 26, Tiranë, Shqiperi.
- 4.2 Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3 Asambleja e Ortakëve mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar.
- 5.2 Shoqëria mund të priset përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E PJESËVE TË KAPITALIT

Neni 6 – Kapitali themeltar i shoqërisë

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000 (njemije) lekë.
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (nje) kuote, kapital i cili paguhet në para nga Ortaket;

Z. Klevens Toka, i biri i Gjergjit dhe Natashes, i dtl. 01.06.1978, lindur dhe banues në Tiranë, në Rr. "Durrësit", pall. 124, shkalla 1, apart. 6, mbajtes i dokumentit të identifikimit letërnjoftim Nr. 033902364 dhe me nr personal H80601183J, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotëruar i 1 (nje) kuote të kapitalit me vlerë nominale 1.000 (njemije) leke, që përfaqëson 100 % (njqind) të kapitalit.

Neni 7 – Ortaku

- 7.1. Ortak i Shoqërisë do të jetë:

Z. Klevens Toka, i biri i Gjergjit dhe Natashes, i dtl. 01.06.1978, lindur dhe banues në Tiranë, në Rr. "Durrësit", pall. 124, shkalla 1, apart. 6, mbajtes i dokumentit të identifikimit letërnjoftim Nr. 033902364 dhe me nr personal H80601183J, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotëruar i 1 (nje) kuote të kapitalit me vlerë nominale 1.000 (njemije) leke, që përfaqëson 100 % (njqind) të kapitalit.

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesëmarrësve në mbledhjen e asamblese, që mbahet nga ortaket që zotërojnë jo më pak se 50%+1 të votave sipas kapitalit themeltar.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortaket kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortaket nuk e ushtrjnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortaket e tjerë proporcionalisht me pjesëmarrjen respektive.

Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së



Ortakëve, të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesmarresve ne mbledhjen e asamblese, qe mbahet nga ortakët qe zoterojne jo me pak se 50%+1 te votave sipas kapitalit themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

- 9.1.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 10 – Transferimi i pjesëve të kapitalit dhe e drejta e parablerjes

- 10.1 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Në rast transferimi të pjesëve të kapitalit në çdo lloj forme në favor të personave të tjerë nga ata të parashikuar më sipër, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim, me çdo kusht, duke përfshirë edhe dhurimin, ortakët e tjerë gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi këto pjesë kapitali.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë pjesët e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me konfirmim marrje ne dorezim, mbi synimin për shitjen, çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha pjesëve të kapitalit ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande me konfirmim marrje ne dorezim, për t'i komunikuar ortakut që transferon pjesët e kapitalit, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, pjesët e kapitalit të ofruara nga ortaku që transferon pjesët e kapitalit, do të ndahen nga ortakët pranues, në masë proporcionale me pjesët që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të ndryshme ndërmjet paleve. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, pjesët e kapitalit mund t'i transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë që përfaqëson të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesmarresve ne mbledhjen e asamblese, qe mbahet nga ortakët qe zoterojne jo me pak se 50%+1, në përputhje te ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".
- 10.7 Në rast të transferimit të pjesëve të kapitalit për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj sipas modaliteteve të parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 11 – Asambleja e Pergjithshme e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Pergjithshme e Ortakëve (ose vendimet e Ortakut te vetem).
- 11.2 Vendimet e Asamblesë duhet të miratohen, si në mbledhjen e parë ashtu edhe në atë vijuese, nga ortakët që përfaqësojnë të paktën të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesmarresve ne mbledhjen e asamblese, qe mbahet nga ortakët qe zoterojne jo me pak se 50%+1 te votave sipas kapitalit themeltar. Vendimet janë të detyrueshme për ortakët që nuk janë të pranishëm ose që nuk janë dakord, përveç së drejtës së tyre të kundërshtimit që ushtrohet në rastet, afatet dhe format e parashikuara nga ligji.



Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i pjesëve të kapitalit që ai zotëron.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, dhe/ose ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve ose nga eksperti kontabël (nëse është i emëruar), ose nga likuidatori/likuidatorët si dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 1/10 (një të dhjetën) e kapitalit themeltar.
- 13.3 Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande që duhet t'u dërgohet ortakëve – në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë. Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, me kusht që të jete në Shqipëri.
- 13.4 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'i lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të argumenteve; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.5 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.6 Asambleja vendos mbi ndryshimet në Statut me votën *pro* të ortakëve që përfaqësojnë të paktën të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesëmarrësve në mbledhjen e asamblese, që mbahet nga ortakët që zotërojnë jo më pak se 50%+1 të votave sipas kapitalit themeltar.
- 13.7 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga e njëjta Asamble. Për mbajtjen e verbalit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.8 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

Neni 14 – Administrimi

- 14.1 Shoqëria administrohet nga të paktën 1 (një) Administrator i cili qëndron në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen ose deri në afatin e caktuar nga Asambleja në aktin e emërimit, por maksimumi i mandatit të tij është 5 vjet. Pas perfundimit të këtij afati Administratori duhet të emerohet me vendim të asamblese.
- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë për një periudhë 5 vjecare i takon Administratorit **Znj. Dorina Mema**, e bija e Petritit dhe Razies, e dtl. 18.11.1980, lindur dhe banuese në Tiranë, në Rr. "Fortuzit", ndërtesa 13, hyrja 7, apartamenti 14, mbajtëse e dokumentit të identifikimit leternjoftim Nr. 034638945 dhe me nr. Personal I06118044M, madhore dhe me zotesi të plote juridike për të vepruar. Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh. Kompetencat e Administratorit janë të percaktuara në ligjin në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".



- 14.3 Gjithsesi Administratori nuk mund të nënshkruajë kontrata pengu ose kredie në emer dhe për logari të shoqërisë, pa vendim të asamblesë së ortakëve për këtë qëllim. Administratori nuk mund të nënshkruajë kontrata për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme në emer dhe për logari të shoqërisë, pa vendim të asamblesë së ortakëve për këtë qëllim.
- 14.4 Administratorit nuk i lejohet të kontraktojë në çfarëdo formë qofte, të marrin hua tek shoqëria, të japin pelqimin në emer të saj, për paradhënie si dhe të behen dorezanes apo të garantojnë në emer të saj angazhimet ndaj të tjetërve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar, emëruar për 6 (gjashtë) vjet.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet në çdo moment sipas mënyrave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.
- 16.2 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe nese janë të nevojshme të ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë më tepër se 2/3 të kapitalit themeltar.
- 16.3 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pesë për qind) që caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë për qind) e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumatat që Asambleja vendos t'i vë në mënjancë, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara respektivisht.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet e statutit të shoqërisë.
- 18.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, pazotësisë juridike, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria do të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin



financiar përfundimtar, mbi vlefshmerine e punës se kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin dhe zgjidhjen e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës e Shkalles së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 21 – Gjuha

- 21.1 Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.
- 21.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, versioni në shqip do të jetë i vetmi dhe do të jetë ligjërishit detyrues.

Ky Statut u nënshkrua lirisht nga nga Ortaku i vetem duke shprehur vullnetin e lire dhe të plote.

ORTAKU I VETEM

Z. Klevens TOKA

KLEVENS TOKA

